

KËRKO

DITARI EKONOMIA OPINIONE SPORTI **KULTURA** ZIP AUTO & TECH KIDZ KRONIKA E ZEZË

KULTURA



BALLINA / KULTURA / KULTURA

Guximi dhe përgjegjësia e autorëve në "Polip"

Drilon Pulaj

Publikuar: 22.04.2013 - 10:19

Komente (0) Printo

Publiko në:  


Ndonëse në vllugun e ngjarjeve politike dhe të kamufluar nga situata e rëndë sociale e ekonomike, kultura është ajo që sjell oazat e largimit nga përditshmëria e rëndë. Më saktë letërsia dhe njerëzit që krijojnë botën e letrave.

Edicioni i tretë i Festivalit Ndërkombëtar të Letërsisë "Polip" 2013, do të nisë në ditët e nxehta të majit. I organizuar nga Qendra "Multimedia" në Prishtinë dhe nga organizata kulturore "Beton" nga Beogradi, festivali këtë vit do të ketë temën e guximit dhe përgjegjësive autoriale. Çfarë duhet për të pasur guxim, dhe cilat janë përgjegjësitë që mbajnë autorët? Këto tema bosht, lexime publike, diskutime mbi temat e statusit letrar në komunitetet e ndara dhe ato në aspektin e krizës politike do të zhvillohen gjatë tri ditëve sa zgjat festivali i letërsisë nga autorë vendas e autorë nga rajoni, Shqipëria, Qipro, Greqia, Hungaria, Izraeli, Gjermania etj. Në kuadrin e festivalit, që do të mbahet nga 10 deri 12 maj, do të ketë një edicion special kushtuar revistës për kulturë "Beton" nga Beogradi, e cila do të botohet në gjuhën angleze me përmbajtje të pjesëve letrare të pjesëmarrësve të festivalit, ndryshe nga viti i kaluar kur revista "Beton" qe botuar në

MË TË LEXUARAT

MË TË KOMENTUARAT

Sërish nuk merren vesh
Daçiq: Serbët janë popull i çuditshëm
Palit i pengon drejtësia, "konfiskohet ga...
Serbët e nisin me barrkada, bllokohen f...
Lind Messi nga Struga
"Zëri" ua zbuloi dallaveret
Vazhdon të jetë një fytyrë reklamuese
E pyesin Daçiqin: Kryeministër, a po fle...



Sjell një trend të ri në modë

Kreatorja e njohur Afërdita Paqarada sapo ka realizuar brendin më...



Kush ishte në lidhje me Noizyn?

Një javë më parë shtëpia e "Big Brother" në Shqipëri...

ZËRI NË FACEBOOK 

Like

13,632 people like this.

TWEET #KOSOVA 


gjuhën shqipe.

Dramaturgu e organizatori i festivalit, Jeton Neziraj, nga Qendra "Multimedia", thotë se përgatitjet deri tash po shkojnë mirë. Neziraj thotë se aktualisht organizimi i "Polip" është në fazën e finalizimit të programit dhe se të gjithë autorët kanë pranuar ftesën, numri i të cilëve në këtë edicion shkon mbi 40 shkrimtarë, muzikantë apo aktivistë kulturorë.

"E veçanta e këtij edicioni është se sivjet është festivali, përtej atij karakterit regional që ka pasur deri më tani, tash ka marrë karakter të plotë ndërkombëtar", ka thënë Neziraj. Festivali këtë vit financohet nga "Allianz Kulturstiftung", "Goethe Institute", "Traduki", "The Olof Palme International Center", "Swedish Institute".

Një numër autorësh të këtij viti do të marrin pjesë për herë të parë. Ata vijnë nga vende të ndryshme dhe nga kultura të ndryshme. "Në festival kemi ftuar shkrimtarë e artistë të tjerë edhe nga Gjermania, Hungaria, Suedia, Spanja e Amerika", tregon Neziraj. Si viteve të kaluara, edhe këtë vit do të ketë përkthime në gjuhët e dy organizatorëve, nga shqipja në serbisht dhe anasjelltas. Përkthimi i librit biografik të Shkelzen Maliqit "Shembja e Jugosllavisë, Kosova dhe rrëfime të tjera" tashmë është përkthyer në gjuhën serbe dhe së shpejti do të botohet në Serbi nga qendra "Beton". Ndërsa në Kosovë, Qendra "Multimedia" do të botojë romanin e autorit serb Sasha Iliq "Rënja e Kolumbisë". Të dy këto libra janë përkthyer nga Anton Berishaj dhe pritet të dalin para publikut deri në qershor të këtij viti.

Shpesh thonë se diçka e mirë dhe e bukur nuk ka nevojë për shumë glamur e shkëlqim, për fasadë a për tepih të kuq. Mbase këtë simbolizon edhe festivali i letërsisë "Polip".



KOMENTO

Komente (0)

Enri*

Email*

Vendi*

Komenti*

1000

ME SHUME NGA KULTURA



Guximi dhe përgjegjësia e autorëve në "Polip"



DW edicion special për vjedhje në kishat shqiptare



ASHASH kundër ndërhyrjes në gjuhën standarde



Stone, Troni e Matoshi në "Chopin"



Çmimet "Pulitzer" për gazetari dhe art



Përgatitjet përfundimtare për festivalin "Hasi Jehon"



Gjakova prodhon të parin muzikël shqiptar



Lojërat popullore, thesare vlerash kombëtare

KRONIKA E ZEË



Hidhet nga kati i katërt, vdes 39-vjeçari



DASH: Në Luginë, të rinjtë shqiptar arrestohen për motive politike

BALLINA



Ballina e Gazetes ne PDF

Download

E Hënë, 22 Prill 2013

THUAJE ME ZË

Cilën rubrikë në Zeri.info e lexoni më së shumti?

- Ditari
- Ekonomia



Dinamika e munguar në Amëbën e Kerkezit



Stand-up komedia dhe mizëria



Filmat e "DokuFesit" edhe në "Neisse Film Festival" në Gjermani



Morfologjia e cyberinjanorancës

- Opinione
- Sporti
- Kultura
- ZIP
- Auto&Tech
- KIDZ
- Kronikë e Zezë

Voto

ZGJEDHJA E REDAKTORIT



Lugina e Preshevës pret bisedime



MPB po ecën zvarrë



Marrëveshja pret "lejen" e Kuvendit



LDK pro, Vetëvendosje kundër marrëveshjes



Nuk ka ligj për pensionim, të sëmuret japin mësim

DITARI EKONOMIA OPINIONE SPORTI KULTURA ZIP AUTO & TECH KIDZ KRONIKA E ZEZË

Ky portal mirëmbahet nga NPIB "Zëri". Materialet dhe informacionet në këtë portal nuk mund të kopjohen, të shtypen ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër për qëllime përfitimi, pa miratimin e drejtuesve të "Zërit". Për ta shfrytëzuar materialin e këtij portali, obligoheni t'i pranoni Kushtet e përdorimit. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara © 2010 Portali "Zëri" | redaksia@zeri.info | marketingu@zeri.info | Tel: 00 38 24 90 71 & 00 38 22 24 51